



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL**

**PLK. D. nr. 652/23**

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT**, i përbërë nga Valdete Daka, kryesuese e Panelit, Burim Ademi dhe Argjira Asllani, anëtar të panelit, me pjesëmarrjen e Mersime Mehmeti, u.d. koordinatorë të panelit për lirim me kusht, duke vendosur përkritazi me kërkesën për lirim me kusht, të parashtruar nga i dënuari F. H., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje grabitje e mbetur në tentativë nga neni 317 par. 3 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej tri (3) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 500€, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prizren, PKR.nr.126/2021, i datës 01.03.2022, pas shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht dhe shkreave të lëndës, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117 dhe 118 të Ligjit (08/ L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, në seancën e mbajtur me datë 07.12.2023, në selinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. HUDHET POSHTË** kërkesa për lirimin me kusht e të dënuarit F. H. nga i ati A. dhe e ëma Xh., e gjinisë G., i lindur me datë ..., P., ku edhe e ka vendbanimin në rr. "...", p.nr., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **si e parakohshëm**.

**II.** F. H. ende nuk është kualifikuar për shqyrtim për lirim me kusht ngase ende nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për aplikim për lirim me kusht, i njëjti e arrin kushtin me datë 16.05.2024.

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i kërkesës, i dënuari F. H. me kërkesën e tij të datës 30.10.2023, e parashtruar përmes Qendrës Korrektuese ..., i është drejtuar Panelit për lirim me kusht, me të cilën kërkon lirimin me kusht, për pjesën e mbetur të dënimit.

Paneli për lirim me kusht ka shqyrtuar kërkesën e të dënuarit, raportin përmbledhës të përpiluar nga ekipi profesionist i Shërbimit korrektues të Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

*Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave të paraqitura në shkresat e cekura më lartë, paneli ka gjetur se:*

Qendra Korrektuese në ... me datë 30.10.2023, ka proceduar dosjen e të dënuarit F. H. para afatit ligjor për t'u shqyrtuar nga Paneli për lirim me kusht.

Në dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06/L-074) me konkretisht në nenin 90 par. 2 përcaktohet se ***“personi i dënuar për veprë penale për të cilën është paraparë dënim me të paktën pesë (5) vjet burgim, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dy të tretat (2/3) e dënimit të shqiptuar, ndërsa për vepra tjera penale, personi i dënuar mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar”***.

I dënuari ka filluar vuajtjen e dënimit me 24.10.2022 dhe sipas llogaritjes rezulton se lirimi i zakonshëm është caktuar për datën 16.05.2025, dhe koha e llogaritjes në paraburgim, prandaj sipas llogaritjes prej 3 vite, del se i ***njëti 2/3 e dënimit i vuan me 16.05.2024 kur edhe kualifikohet për lirim me kusht***.

Vepra penale në bashkëkryerje grabitje e mbetur në tentativë nga neni 317 par. 3 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, hyn në kategorinë e 2/3 të dënimit me burgim meqë për këtë veprë përkatësisht par. 3 i nenit 317 është e paraparë dënim me burgim me të paktën pesë (5) vjet e rrjedhimisht kjo çështje penale duhet të trajtohet konform nenit 90 par. 2 të KPRK-së lidhur me nenin 12 të Rregullores nr. 01/39 mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për Lirim me Kusht.

Inicimi i procedurës për lirim me kusht fillon konform nenit 15, 16, 17 dhe 18 të Rregullores nr. 01/39 mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për Lirim me Kusht, kështu që kjo lëndë është dorëzuar në kundërshtim me nenin 90 par. 2 të KPRK-së lidhur me nenin 18 të rregullores. Lënda dorëzohet në Panelin për lirim me kusht tridhjetë (30) ditë para se i dënuari të arrijë kushtin ligjor, respektivisht 2/3 e dënimit të shqiptuar dhe jo me herët siç është vepruar në rastin konkret.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 90 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT  
PLK. D. nr. 652/23, datë 07.12.2023**

u.d. Koordinatore e Panelit

Mersime Mehmeti

Kryesuese e Panelit

Valdete Daka

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimit nuk është e lejuar ankesa.